



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 272

Prishtinë, Dt. 29/01/2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMËS
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Fizikë
Projektpropozimi	Vlerësimi i niveleve të radonit dhe toronit në ujërat nëntokësore në Kosovë
Kandidati/ja	Lirije Trolli
Mentori	Prof. Asoc. Dr. Gazmend Nafezi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 27.04. 2023; vazhdimi, 03.07.2024 Vendimi nr. 1869; 2279

Dorëshkrimi i kandidatës Lirije Trolli me titull "Vlerësimi i niveleve të radonit dhe toronit në ujërat nëntokësore në Kosovë" fillon me hyrjen, ku tregohet për rëndësinë e një punimi të tillë. Materiali në kapitullin e parë përmban aspektin teorik të punimit, duke filluar me vetitë fizike dhe kimike të radonit, izotopet e tij dhe produktet e zbrërthimit, aspektet e përqendrimeve të radonit dhe toronit në ujërat nëntokësore dhe aspektet e aktiviteteve që mund të sjellin në dozën totale të pranuar nga mezatimi.

Kapitulli i dytë "Materialit dhe Metodat", përshkruan metodat e matjeve dhe saktësinë e tyre, duke u përqendruar në procedurat standarde të matjeve dhe ato të përdorura në këtë punim.

Kapitulli i tretë paraqet rezultatet e arritura, duke përshkruar lokacionet e përfshira në hulumtim, rezultatet veç e veç në mënyrë tabelare dhe grafike dhe diskutimet e rezultateve.

Punimi pëmbëhet me përfundimet e nxjerra nga rezultatet e arritura, disa rekomandime dhe krahasimet me rezultatet nga hulumtimet tjera.

Prandaj, komisioni për vlerësim të dorëshkrimit dhe mbrojtje të temës master, bazuar në Kërkesën nr.6094, të datës 30.12.2024 për temën **“Vlerësimi i niveleve të radonit dhe toronit në ujërat nëntokësore në Kosovë”** të kandidatës Lirije Trolli, në përputhje me procedurat e rregullores së studimeve master, paraqet këtë:

Vlerësim të dorëshkrimit


Kandidatja Lirije Trolli, temën e nivelit master e ka shkruar në përputhje me kriteret akademike dhe të parapara me rregullore. Tërë materialin e ka shtri në 62 faqe, të sistemuar në 4 kapituj. Materialit i paraprinë: deklarata e betimit, falënderimi, përmbajta, abstrakti, lista e tabelave dhe lista e figurave. Ndërsa përfundon më referencat. Kandidatja në hulumtim ka shfrytëzuar një numër të konsiderueshëm të literaturës aktuale (12), ndërsa për shtjellim të temës ka ndërtuar 17 tabela dhe 21 figura. Formulatat, tabelat dhe figurat janë kompatible me tekstin. Shtrimi dhe shtjellimi i temës është në përputhje me normat pedagogjike dhe hulumtuese.

Komisioni mendon se me qëllim të rritjes së kualitetit të punimit, kandidatja duhet të bëjë edhe këto përmirësime:

1. Të gjitha figurat dhe tabelat që nuk janë punë e kandidatës të pajisen me referencë.
2. Evidentimi i referencave të jetë homogjen.
3. “Përfundimi”, ky që është tani në punim, të largohet krejtësisht dhe të shkruhen “Përfundimet” së riu, të bazuara në rezultatet e punimit.

Përfundim: 29.01.2025

Komisioni:

1.  _____

/ Prof. Dr. Shukri Klinaku – kryetar/

2.  _____

/ Prof.Dr. Naim Sylja – anëtar /

3.  _____

/ Prof. Asoc.Dr. Gazmend Nafezi – anëtar

(mentor)/